

**NARRATIVE STRATEGY AND TIPOLOGY OF CHARACTERS IN THE NOVEL
MASTER AND MARGARITA BY MIKHAIL BULGAKOV**

Emine Shabani

University of Tetova, Republic of Macedonia emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract: In the 1930-ties, in communist Russia the arts and literature were under party censorship. Some decades before the tradition of the postmodernist novel had started, Mikhail Bulgakov wrote "Master and Margarita", where the fantastic, religious, para-psychological, satyric elements are interwoven, as well as the retrospective digression into the historic past that contains in its core the ironic, subversive and critical positions.

The novel includes many forms of writing some of which are: intertext and its derivatives, magic realism, palimpsest etc. The prose of Bulgakov does vary in its content compared to the literary currents of the time and previous ones, the focus of narration lies in those narrative strategies that digress into the historic past in order to ironically criticize the vices and ideology of the communist man.

The novel "Master and Margarita" is a modernist novel as far as the factography of the narrator or the protagonist, an important aspect in the study of this novel is the typology of the characters, time and space as typical elements of modernist prose and their hidden meaning. The role of the defender of the master, to our surprise, is assumed by Woland who is the incarnation of the devil.

In this essay the narrative techniques of the author will be included as well as the parallels to "Faust" by Goethe and its influence in the works of Bulgakov.

Keywords: narrative strategy, trajectory of narration, space and time, crime and punishment, context and code etc.

**STRATEGJI TË NARRACIONIT DHE TIPOLOGJIA E PERSONAZHEVE TE
ROMANI MJESHTRI DHE MARGARITA TË MIKHAIL BULGAKOVIT**

Emine Shabani

University of Tetova, Republic of Macedonia emine.shabani@unite.edu.mk

Abstrakt: Në vitet e 30-ta në Rusinë komuniste artet dhe letërsia ishin nën censurën partiake. Disa decaie para se të fillojë tradita e romanit postmodern Mikhail Bulgakov shkroi veprën Mjeshtri e Margarita, në të cilën ndërthuren elemente fantastike, religjioze, parapsikologjike, satirike, kthimi në të kaluarën historike që përmbajnë në thelbin e tyre qëndrimin ironik, subversiv e kritik.

Vepra ndërthen në vete disa forma të shkrimit si: interteksti dhe derivatet e tij, realizmi magjik, palimpsesti, etj. Proza e Bulgakov-it edhe nga ana përmbajtësore ndryshon nga rrymat letrare pararendëse dhe të kohës, ajo ka në fokus të rrëfimit ato strategji narrative të cilat kthehen në të kaluarën historike, për të ironizuar dhe kritikuar ato vese dhe ideologjinë e njeriut komunist.

Vepra Mjeshtri e Margarita, është roman modern nga faktografia e narratorit gjegjësisht personazhit kryesor, një element i rëndësishëm i studimit të kësaj vepre është edhe tipologjia e personazheve, koha dhe hapësira si elemente tipike të prozës moderne dhe prapaskaena e tyre. Në rolin e mbrojtësit të Mjeshtrit, në roman çuditërisht del Wolandi që është mishërim i djallit

Në punim do të përfshihen teknikat narrative origjinale të autorit, si dhe paralelizmi dhe ndikimi i Faustit të Goethe-s në veprën e Bulgakovit.

Fjalët kyçe: strategji të narracionit, trajektorja narrative, hapësira dhe koha, krimi dhe ndëshkimi, konteksti dhe kodi etj.

Rezultatet: Nëpërmjet implikimit të figurave biblike në Rusinë e viteve të 30- ta Bulgakovi do ta shkruajë romanin Mjeshtri e Margarita me të cilën do të lërë gjurmë në letërsinë botërore, ashtu si Fausti i Goethe-s Hamleti i Shakespeare-it, apo Komedia Hyjnore e Dante Alighieri-t. Roman fikcional, me implikime historike-biblike me karakteristika të realizmit magjik, elemente intertekstuale për gërshetimet historike dhe religjioze në një shoqëri ku ateizmi ishte normë shtetërore.

Ndikimi i Faustit të Goethe-s duket tek emri i djallit Woland, që përfaqëson emrin e fshehtë të Mefistofelit që e përdor vetëm në natën e Valpurgës. Emrat e personazheve të bëjnë të kuptosh për implikimet historike dhe tiparet karakterologjike të personazheve. Rrjeta e thurjes së veprës është unike dhe origjinale, për formën e komunikimit dhe referimit të veprës me tekstin biblik, nëpërmjet ndërthurjes së ngjarjeve rreth vdekjes së Joshuas (Jezusit), gabimit të Pontij Pilatit, ndërhyrjes së djallit në mendësinë dhe kodet shoqërore, ato të komunikimit dhe mënyrën e

mendimit të moskovitëve, si dhe intervenimin e tij, që e përbën shtresën satirike të romanit. Autori e fillon romanin me një invencion të qëlluar:

*‘‘ E kush je t'i pra\?
Jam pjesë e asaj force
Që gjithmonë dëshiron të keqen
por gjithmonë krijon të mirën !*

Goethe, Faust’’.⁸⁶

Ivani i pastrehë dhe Berlioz bisedojnë për ateizmin (janë vitet e 30-ta në Moskë). Ekspozicioni nis me dialogun mes krijuesve Ivan Nikolajevič Bezdorni dhe Berliozit dhe hapet me frazën e njohur të Mefistofelit nga Fausti i Goethes. Romani ka një gërshetim unik në përmbajtje dhe në karakterizimin e personazheve. Mban titullin e Mjeshtrit dhe Margaritës, por protagonist i tij është satanai Woland, i cili i lëviz ngjarjet në favor të Mjeshtrit dhe dashurisë së tij Margaritës. Woland-i në momentin që shkel në Moskë demaskon demagogjinë e zyrtarëve, hilet e shoqatës së artistëve dhe shkrimtarëve rusë, në veçanti emrat e disa kritikëve që pengojnë punën krijuese dhe botuese të Mjeshtrit: Latunski, Mtsislav, Berlioz, etj.

Narratori përdor teknikën e adresimit direkt dhe e fillon me një karakterizim të hutuar të vetvetes si narrator me një veti të shprehur dhe një spektër të paqartë të njohurive. Ka fërkime mes narratorit të gjithëdijshëm që i di mendimet e personazheve dhe narratorit personazh me njohuri të kufizuara. Gjuha që përdoret mes popullit sikur tregon se njerëzit e kanë në ndërdije që pranë tyre është prezent djalli! Ata mendojnë në formë monologjuese dhe në momente afekti shprehen me zë ‘‘cilin drej e do’’ ‘‘ dreqi..e di’’, ‘‘në drej shkoftë’’, ‘‘dreqi e marrtë’’, ‘‘çfarë drej bëmë’’, ‘‘kush drej të thirri’’, etj.

Romani e ndërron paradigmën e romanit të kohës kur u shkrua. Ai paraqet një botë të realizmit magjik me një simbolikë të fuqishme dhe domethënëse, siç e përdori Ezopi artin e tij në antikë kundër kastës qeverisëse të Athinës. Autori rreh në ato elemente dhe vese njerëzore të këqija nëpërmjet gojës dhe veprimeve të Wolandit, si mëkatet vdekjeprurëse :lakmia, mendjemadhësia, xhelozia, tradhtia, vrasja, amoraliteti, vjedhja, etj. Babai Bulgakov-it, Afanasij Ivanovič Bulgakov ishte profesor në akademinë teologjike në Kiev, kjo qartëson se ai e ka njohur mirë historinë e religjionit dhe Jezu Krishtin me Pontij Pilatin. Narratori nëpërmjet Woland-it rrëfen për Immanuel Kantin dhe kritikën e mendjes së kulluar, për pesë parimet e Thoma Aquin-it, që Kanti nuk i pranoi por më pas jo vetëm që i pranoi por edhe i plotësoi dhe shtoi edhe të gjashtë. Romani ka paralelizma me Biblën, Komedinë Hyjnore të Dante Alighieri-t, rendjen kah absolutja e Faustit të Goethe-s, me dilemën hamletiane të Shakespear-it.

Wolandi si djall që është shndërruar në papagall dhe rrotullohet rreth fontanës në kopshtin e prokuratorit të pestë të Judesë Pontij Pilatit, për ta vëzhguar gjykimin dhe dënimin e Joshuas. Antropomorfizmi është dukuri në këtë vepër edhe tek Behemothi, Hela, të cilët kalojnë në antropomorfizëm në çaste krejt të papritura.

Në çdo episod dhe kapitull të romanit krahasimet biblike janë mjaft intensive. Margarita mallkon veten pse nuk ndenji me Mjeshttrin natën që ai e dogji dorëshkrimin, ndërsa kur u kthye të nesërmen atë e kishin arrestuar. Sipas shënimeve biografike Bulgakov-i punoi rreth dymbëdhjetë vjet në këtë roman duke e shkruar e korrigjuar vazhdimisht, edhe në ditët e fundit të jetës, ai i diktonte gruas së tij pasazhe nga versioni përfundimtar i librit. Lidhja logjike dhe reale duket se është deri tek momenti kur Margarita e sheh për herë të fundit Mjeshttrin. Ndërsa takimi me Azazelin në parkun e rrugës Sadova, është ëndrra e narratorit dhe gërshetimi fantastik që fsheh të vërtetën e tyre. Ashtu siç ndodh kur djalli zemërohet dhe e ndjen erën e ndryshimeve shoqërore, ai mbin në ato momente kyçe vendimtare, alias Wolandi u shfaq para Kantit si filozof dhe mik i tij, për të diskutuar për parimet e Thomas Aquinus.⁸⁷

⁸⁶ Mikhail Bulgakov, (2015), Mjeshtri dhe Margarita, Biblioteka Koha Ditore, Prishtinë, f. 5.

⁸⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/Thomas_Aquinas Shih gjithashtu edhe: Thomas Aquinas (1225-1274), a Catholic philosopher and theologian, formulated five arguments for the existence of God in his Summa Theologiae (1265-1274).

1. The argument of the unmoved mover (ex motu). Aquinas said that things move, so something or someone - an unmoved mover from whom all motion proceeds - must therefore exist.
2. The argument of the first cause (ex causa). Some things are caused by something or someone else. Therefore, there must be an uncaused cause of all caused things.
3. The argument of contingency (ex contingentia). Many things in the universe may either exist or not exist. Such things are called contingent beings. But it is impossible for everything in the universe to be contingent, therefore there must be a necessary being whose existence is not contingent.
4. The argument of degree (ex gradu). Various perfections may be found in varying degrees throughout the universe, which assumes the existence of the perfections themselves

Vepra e Mihail Bulgakov-it, është një tjetër roman i një disidenti, i shkruar nën diktaturën komuniste, përveç, Zamjatinit, Pasternjakut, Solzhenjicinit, etj. Romani kap periudhën kohore mes të mërkurës dhe të shtunës në Moskë në vendin e quajtur Patriarshki ribnjaci (Pellgjet e Patriarkut), ku kryetari i shkrimtarëve të Moskës Berlioz dhe poeti i ri Ivan Nikolajevič Bezdorni janë duke diskutuar për mohimin e ekzistencës së Jezu Krishtit dhe, hapësira tjetër e rëndësishme që ndërlihet dhe paralelizohet me ngjarjet e rrugës Sadova janë Jerusalemi, Golgota dhe bota transhendente gjegjësisht staza hënore. Devijimi nga kanoni biblik në roman shprehet përmes figurës së Joshuas, i cili nuk është si Jezusi, Woland-i nuk është i njëjtë me djallin, ashtu edhe Pontij Pilati, nuk i lanë duart për tu shfajësuar dhe lehtësuar ndërgjegjen për vrasjen e Jezusit. Ky devijim nga kanoni biblik e bën të veçantë dhe original krijimin e Mikhail Bulgakov-it, nga subjekti biblik.

Sipas gjithë kritikëve ka vende të errëta, mistike në roman dhe duhet të gjendet çelësi që të deshifrohen enigmat. Wolandi në Moskë nuk bën keq, por vetëm e zbulon të keqen dhe i jep formë asaj mes njerëzve që e fshehin brenda, ai gjykon sipas veprave dhe jo sipas jashtësisë. Edhe Joshua edhe Wolandi, interesohen për përparimin e brendshëm, vertikalen morale-shpirtërore të njerëzve, por interesi i tyre është i ndryshëm, ai ndahet në resorë. Wolandi do të thotë se qeveria është demonike, i korrupton i mashtron dhe i frikëson njerëzit, sikur thënia e perandorëve romakë *panem et circuentum* (bukë dhe lojëra), por shpeshherë mungonte edhe buka, edhe hapësira banesore, andaj sherri i madh plasi edhe për banesën numër 50 e të ndjerit Berlioz. Edhe ky problem u shfrytëzua dhe mori formë nga Wolandi, u ekzekutua me mjeshtëri djallëzore nga Korovjevi dhe Behemothi. Woland përfaqëson mishërimin e djallit, që e parë në dritën e psikologjisë së Jungut hija kolektive e mishëruar në djall, (Wolandi), shtrigë (Hella), ose diçka tjetër. Në këtë rast Wolandi përfaqëson një të keqe që largon të keqen tjetër kolektive dhe këtë e bën fare lehtë duke nxitur të dalë në sipërfaqe atë që vlon brenda në shpirtat dhe ndërgjegjen e moskovitëve. Përmes parodizimit të veseve njerëzore dhe vëzhgimit të Woland-it në teatër, se për një kohë të gjatë është bërë përparimi teknologjik, por degradimi shpirtëror kishte arritur kulmin. Raporti i shpirtit dhe trupit paraqet një problem shumë të madh dhe gati të pazgjydhshëm. Lakmitë, dëshirat, veset, krenaria, zilia, janë frenat e përparimit shpirtëror. Këtë test e bën Korovjevi dhe Behemoth-i në teatër dhe të gjithë bien pre e lakmisë, si burrat ashtu edhe gratë.

Mbarimin e veprës autori ia beson Ivan Bezdornit. Ai nëpërmjet vizionit parashih se çfarë do të ndodhë me Pilatin dhe Mjeshtrin. Bashkëveprimi i personazheve, telepatia e Ivanit dhe reagimi i drejtpërdrejtë i Margaritës inicojnë zgjidhjen e problemit të Pilatit, i cili nuk gjeti paqe dy mijë vjet derisa u takua me Joshuan bisedoi iu lut ta falë dhe i ra guri i rëndë nga zemra që e kishte mbajtur plot dy mijë vjet. Staza hënore në të cilën ecin Pilati dhe Joshua është metafora e arritjes në mbretërinë e dritës. Mohimi i librit dhe Margaritës nga Mjeshtri, ashtu sikurse edhe mohimi/mbytja e fëmijës nga Frida, edhe mohimi i Joshuas nga Pilati, do të inicojë nevojën e faljes për të shpëtuar dhe për të arritur në Mbretërinë e Dritës. Afria, ndikimi dhe paralelizmi me Faustin e Goethe-s janë të pashmangshëm në roman, por vend dhe rol të veçantë aty Bulgakov-i i jep Levi Matej-it, për dallim nga Fausti.

Jungu e admironte Faustin, më shumë se Ungjillin e Shën Gjonit. ‘Në të kishte njëfarë jete, për të cilën unë kisha simpati. Kurse Krishti nga ‘Joani’ ishte i huaj për mua, edhe pse, ndoshta jo në atë masë sa ‘shëruesi’ nga Sinopsis. Tek Fausti [...] unë shihja përgjigjen e Goethe-s për problemet e kohës së vet.’⁸⁸

Duhet cekur gjithashtu se Jungu që në vegjëli ishte i ndrojtur por tani ‘nuni dhe garani’ për Jungun ishte Goethe. Ai kritikon Faustin dhe Goethe-n njëkohësisht:

‘Por duhet thënë se konceptet e mia mbi Faustin kufizoheshin me kaq . Pavarësisht nga gjithë simpatia ime për Faustin, unë nuk e pranoja zgjidhjen e Goethe-s ndërsa qëndrimi i tij mendjehetë ndaj Mefistofelit, më lëndonte personalisht, nësoj si edhe mendjemadhësia e ndyrë e Faustit por mbi të gjitha s’mund të pajtohesha me vrasjen e Filomenës dhe Bauikidës.’⁸⁹ Qëndrimi i Mjeshtrit tek Bulgakov-i është dinjitoz. Ai nuk është i lidhur drejtpërdrejtë me Woland-in, por këtë ndërmjetësim e bën Margarita nëpërmjet Azazelit, tani gruaja është ajo që do ta shpëtojë dashurinë e saj Mjeshtrin, ndërsa Fausti e viktimizon Margaritën/Gretën.

Ndërsa Joshua thotë se çdo qeveri është dhunë mbi njerëzit dhe, se do të vijë një ditë kur nuk do ketë nevojë për mbretër, ku do do të mbretërojë drejtësia... Gjatë kalimit/anticipimit në kapitullin tjetër, Mjeshtri bisedon me Ivanin në spitalin psikiatrik dhe tërthorazi e qorton si nuk ke dëgjuar për djallin, nuk dyshove aspak në sytë e tij

5. The argument of design (ex fine). All designed things have a designer. The universe is designed. Therefore, the universe has a designer.

German philosopher Immanuel Kant (1724-1804) added a sixth argument to those mentioned above, called the argument of the moral order. Kant said that we are rationally obliged to attain the summum bonum. And what we are obliged to attain, must be possible for us to attain. If there is no God or afterlife, it is not possible to attain the summum bonum, so God or the afterlife must exist.

⁸⁸ Carl Gustav Jung (2006), Kujtimet, ëndrrat, përsiatjet Fan Noli, Tiranë, f. 103.

⁸⁹ Carl Gustav Jung (2006), Kujtimet, ëndrrat, përsiatjet Fan Noli, Tiranë, f. 103.

: "Ja...fytyra që e përshkruat, sy të ndryshëm, vetulla! Më falni, përveç tjerash ndoshta as operën »Faust« nuk e keni dëgjuar?"⁹⁰

Tipologjia e personazheve : Vepra ka simbolikën e ngjyrave, numrave, kohës, figurave paralele dhe ngjarjeve të paralelizuar. Lulet e verdha në duart e Margaritës, Mjeshtri i quan lule të së keqes. Janë pikërisht këto lule, që ia tërheqin vëmendjen dhe zbrazësia e syve të saj. Ky takim është arketipor, ajo e kishte dashur atë shumë më herët para se ta takonte. Vetë Mjeshtri mishërohet me figurën e Krishtit të shek, njëzet ndërsa Margarita me Levi Matej-in që ishte vonuar për ta shpëtuar Mjeshtrin e tij. Edhe natyra përsërit dukuritë e revoltës të shoqëruara me shi e fortunë, kur vdes Mjeshtri ashtu siç kishte qenë para dy mijë vjetësh kur Pontij Pilati e dënoi Joshuan. Narratori na rrëfen se Pilati ishte mjaft vigjilent për personalitetin e Joshuas dhe se Haifa bashkë me Sinhedrinin kishin vendosur ta dënonin "filozofin e urtë" siç e quan Pilati e jo kriminelin e lig Ban Rabanin. Revolta dhe urrejtja e Pilatit shfaqet kur ai bisedon me Haifën, por ky i fundit me ankth e pret vrasjen e Joshua-s. "Pastrimi" metaforik i duarve të Pilatit mund të quhet urdhri që ai jep të vritet Juda dhe tridhjetë tetradrahmat e gjetura tek trupi i tij bashkë me një letër të hidhen në oborrin e sinhedrinin, si dëshmi se ata ishin dorasit e vrasjes së "filozofit të urtë". Ndërrim i subjektit që rrëfëhet në Bibël, Pilati i përshkruar në librin e Shenjtë nuk tregon dhimbje por zbaton "drejtësinë", ndërsa tek Mjeshtri ai do të reagojë menjëherë për t'i futur në kurth ata që e inskenuan fajin e Joshuas.

Pilati as me këtë akt nuk do jetë i qetë, ai vdes shpejt dhe *rruga nderore* për të nuk do jetë e lejuar për dy mijë vjet. Pranë tij në mënyrë simbolike qëndron qypi i thyer i verës së kuqe që u derdh para dy mijë vjetësh dhe, që gjithmonë ia kujton gjakun e shenjtë të Krishtit/Joshuas që u derdh me urdhrin e tij, por sigurisht që ai pati mundësi edhe ta ndalte këtë vrasje! Deri në momentin kur shpirtin e Pilatit do t'a shoqërojnë edhe shpirti i Mjeshtrit dhe Margaritës dhe, kur ata do të urdhërojnë që të çlirohet nga ankthi i dënimit, ai do të vuajë nga brejtja e ndërgegjes.

Një tjetër simbolikë e goditur është edhe shpura e Woland-it gjegjësisht figura antropomorfe e maces së zezë Behemotit.⁹¹ Wolandi, Azazeli,⁹² Behemot-i, Mjeshtri, Margarita, Latunski-Lunaçarski, Arimani, Berlioz, Ivan Nikolajevič-Bezdomni, Rimski, Varenhuka, Pontij Pilati, Joshua.

Emrat e tyre janë arketiporë, që lidhen me emra nga e kaluara historike në përputhshmëri me veprimet që kanë bërë në jetën e tyre. Emra mitologjikë, real dhe fiktiv. Elementet antropomorfe janë prezente tek shpura e Wolandit Behemoti- macja e zezë, përfaqëson mishërimin e djallit sipas të gjitha besimeve folklorike në botë. Narratori e shndërron djallin në papagall, gjatë gjyqit të Jeshuas në Jerushallajm.⁹³ Gjithashtu edhe qenushi qimredhur mishëron djallin dhe atributet e tij.⁹⁴

Woland-i gjatë bisedës me Ivan N. Bezdomnin dhe Berliozin përmend se ky i fundit do të vdes nga "një grua", e cila në kohën narrative është kryer, pra Anushka tashmë e ka blerë vajin dhe ai është derdhur ! Megjithëse është e vështirë ta ndash këtë personazh nga rrëfimi i autorit. Më tej rrëfimtari tregon çka ngjarë më parë. Në këtë moment vështrimi i rrëfimitarit ka kapërcyer atë që e shohin personazhet tjera.⁹⁵

Wolandi vjen në Moskë që t'a demoskojë korrupsionin, padrejtësitë, mohimin e botës transhendente, spiunimin mjerimin shpirtëror, etj. Është roman i parë ndoshta i vetmi deri tani ku roli i djallit ndërlikohet dhe jepet një karakterizim unik i figurës së tij. Ai shndërrohet në professor të magjisë së zezë, i thirur nga sovjetikët në një

⁹⁰ Mikhail Bulgakov, (2005), Mjeshtri e Margarita Biblioteka Koha Ditore, Prishtinë, f. 142. Shih gjithashtu edhe: Ky aluzion tregon ngjashmëritë midis Mjeshtrit dhe Margaritës dhe Faustit, një dramë tragjike nga J. W. Goethe, e botuar në dy pjesë në 1806 dhe 1832 dhe konsiderohet të jetë një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë gjermane. Si dhe të operës *Mallkimi i Faustit*, të kompozitorit frëng Hector Berlioz, të shkruar më 1845, për të cilën Bulgakovi kishte njohuri. https://en.wikipedia.org/wiki/La_damnation_de_Faust

⁹¹ Цек Тресидер (2001), Речник на симболи, Сфинга, Скопје стр. 152-153. Macja e zezë në folklorin e shtrigave, përfaqëson afërsinë e saj me satanain, ato gjithashtu asocojnë orgjitë satanike dhe llogariten si ephndjellëse dhe mishërim i ashpër i vetë djallit.

⁹² https://en.wikipedia.org/wiki/The_Master_and_Margarita Shih gjithashtu "Azazello (Аззелло) is a menacing, fanged and wall-eyed member of Woland's retinue, a messenger and assassin. His name may be a reference to Azazel, the fallen angel who taught people to make weapons and jewelry, and taught women the "sinful art" of painting their faces (mentioned in the apocryphal Book of Enoch 8:1-3). This connection could explain the magical cream he gives to Margarita. He also transforms into his real shape in the end: a pale-faced demon-assassin with black empty eyes."

⁹³ Цек Тресидер (2001), Речник на симболи, Сфинга, Скопје стр. 185. Shih gjithashtu: "Zëdhënës, ndërmjetës mes njeriut dhe botës së përtejme, simbolikë e cila rrjedh nga aftësia e këtij shpendi për ta imituar të folmen e njerëzve. Nga ky shkak papagajtë janë ndërlidhur me profecitë. Në Indi dhe Amerikën Qendrore është besuar se ata mund ta sjellin shiun. Në besimet indase gjithashtu është atribut i zotit të dashurisë, Kama. Ndërsa në Kinë përfaqëson treguesin/demantuesin e tradhtive mes njerëzve. Ky atribut pozitiv i është vënë edhe nga autori vetë Wolandit, pasi që djalli mori formën e tij në kohën që u gjykua Joshua nga Pontij Pilati, ai ishte i pranishëm aty dhe këtë dëshmi ua rrëfeu Berliozit dhe Nikollaj Ivanoviç-Bezdomnit.

⁹⁴ <http://www.urbandictionary.com/define.php?term=Mephistopheles> Shih gjithashtu: A demon frequent in occult mythology, and a chief member in the Faust legend. Often seen in the form of a dog, horse, or raven familiar. Mephistopheles promised to serve as Faust's servant for 24 years.

⁹⁵ Floresha Dado, (2003), Teoria e veprës letrare-Poetike, SHBLU, Tiranë, f. 245.

konferencë shkencore, si i vetmi specialist në botë i kësaj lëmie për të deshifruar libra të vjetër të magjisë. Ky armik i Perëndisë në përgjithësi është themeluar si një përfaqësim i palëkundur i së keqes, një shifër për të mashtruar dhe torturuar armiqtë e tij dhe lexuesit njësoj. Pavarësisht nëse bëjnë marrëveshje me njerëzit për të shitur shpirtrat e tyre ose për të rritur ushtritë kundër Qiellit, përfaqësimet letrare të djallit kanë qenë kryesisht të lidhura me tema fetare, shpesh duke përfunduar me një rritje të mposhtjes heroike të Perëndisë mbi të keqen ose "rënien" tragjike të Satanait. Te Mjeshtri dhe Margarita Mikhail Bulgakov e ndërlikon rolin dhe karakterizimin e djallit, një "profesor i huaj i

magjisë së zezë", duke vizituar Rusinë Sovjetike, e cila është e vendosur qartë për të qenë Satani në tokë, duke shkaktuar ligësitë e tij të natyrshme në karaktere tjera. Në roman mund të thuhet se tre karaktere janë kyçe, protagonistë të tij, që na mundësojnë një lexim të ri të figurës së djallit, Joshuas dhe Margaritës gjatë parametrave gnostik. Wolandi është errësira, opozita që mundëson ndriçimin e karakterit të Joshuas, Margarita, lidh paktin me djallin për një qëllim fisnik, Pilati qëndron besnik detyrës së tij edhe pse e di që gabon dhe momenti që ia kthen mendjen është leximi i pergamenëve të Levi Matejit nga sekretari i tij si dëshmi kundër Joshuas, se çdo qeveri është djallëzore dhe do të vijë koha kur bota nuk do ketë nevojë për mbretër, etj. Ky fakt e irriton Pilatin i cili është mbrojtës i Cezar Augustit dhe gjithashtu është moment vendimtar për dënimin e Joshuas. Janë pikërisht elemente ekzistencialiste që vendosin për dënimin e Joshuas, ai del hero i tragjik që u qëndron besnik parimeve të tij, por kjo është edhe një mishmash ngjarjesh dhe veprimesh që dalin krejt papritur sikurse dëshmitë e Levi Matejit, të shpifura dhe të pabazuara për veprimet e Joshuas. Karakterizimi i Joshuas nga Mateji është i gabuar, i ngatërruar dhe i paqartë. Gjithçka është ngatërruar e bërë lëmsh, ndonëse thellë në ndërgjegjen e tij ai e ka të qartë figurën e Joshuas, që e do, që do ta mbrojë por nuk arrin ta bëjë sepse vonohet, këto janë elemente të tragjedisë me mospërputhjen e vendit dhe kohës. Edhe sikur Mateji të kishte mbërritur në kohë, Joshuan patjetër duhet ta vrisnin. I torturuar nga brejtja e ndërgjegjës Mateji rrefuzon çdo shpërblim të Pilatit, e quan atë vrasës dhe do të hakmerret për Judën.

Koha kur u shkrua romani është rreth viteve të 30-ta të shek 20 dhe shumë gjëra akoma nuk kishin arritur të zhduken, besimi në Zot, ndonëse fshehurazi, ruhej në mendësinë dhe traditat e njerëzve. Emri i Woland-it përkon me emrin sekret të Mefistofelit dhe emrit të djallit në mitologjinë gjermane, emri i Margaritës është i pandryshuar. Edhe një fakt interesant është mes dialogut të Ivanit dhe Mjeshtrit që e bën të qartë ndikimin e romanit nga dy krijues të tjerë përveç Faustit të cilin nuk e përmend por nënkuptohet nga Greta e Faustit. Simboli i qenit qëmedredhur i cili është dekor në qaforen dhe këpucët e Margaritës, është një aluzion i Faustit kur Mefistofeli iu paraqit atij në formën e qenushit.

Narratori tregon se bëhet një luftë për ta ruajtur individualitetin por edhe për ekzistencën fizike në një botë të rrezikshme staliniste, me të cilën kujtimet mund të kalojnë mes njerëzve të cilët ishin të largët në kohë dhe hapësirë. Duke vrarë Joshuan ai vret mirësinë njerëzore, ndërsa Wolandi është kundër vrasjes së tij, ai nuk do që Joshua të vritet për të mirën e njerëzimit. Nuk duhet ta kërkojmë mirësinë nga Zoti por prej nesh dhe njerëzve. Atributi i Joshuas është mëshira. Pilati nuk i lan duart por vuan nga gabimi i tij dhe kjo e bën të ndryshëm atë nga rrëfimi biblik. Margarita është gruaja e Mjeshtrit, ajo është e mirë dhe i ndihmon atij, shkon në natën e ballos së satanit për ta ndihmuar Mjeshtrin, pranon të gjitha kushtet që i vendos Wolandi vetëm për ta shpëtuar atë.

Ekziston vetëm përparimi teknologjik dhe jo ai i shpirtëror thotë ndër të tjera Wolandi. Sprova me të hollat që bien nga tavani i teatrit, është e veçantë për burrat, ndërsa butikut superluksoz që hapet nga prapaskena e tij është një mrekulli më vete dhe një sprovë akoma më e madhe për gratë sepse ato nuk mund t'u rezistojnë rrobave të bukura! Wolandi u tregon se qeverisja është djallëzore. Edhe Pilati bën të njëjtën gjë, por në fund urdhëron të vritet Juda. Ai shërbehet me mekanizma djallëzore për të gjykuar dhe qeverisur.

E rëndësishme është Frida që paraqitet në ballo. Ajo është një vajzë që punon në kafene, mbetet shtatzënë me pronarin e saj dhe e mbyl fëmijën, si dënim ajo mba në dorë shaminë me të cilën e ka mbytur fëmijën. Margarita e fal atë. Janë prezent binarët opozitarë si te Stross-i, kodet e Barthesit. Ekuilibri dhe çekuilibri si te Todorovi, dhe funksionet narrative si tek Propp-i, konteksti kulturor, ideologjik, politik. Vetëdija e shkrimtarit identifikohet dendur me natyrën, fenomenet që ndodhin: natyra ndryshon gjatë dënimit të Joshuas, ajo shfaq revoltë nëpërmjet fortunës marramendëse, pas vdekjes së tij ndodh një stuhi e madhe me shi rrëmbyes, edhe në kopshtin e shtëpisë së Mjeshtrit kur i presin kuajt e zi për t'i marrë në "një botë më të mirë", përsëritet skena e stuhisë dhe shiut.

Jungu thotë më mirë mos të kesh gumë të qetë dhe t'i dëgjosh ëndrrat, ato do të udhëzojnë çfarë të bësh ! brendësimi i një problem edhe në ëndërr merr përgjigje. Një pjesë të rëndësishme të romanit zënë ëndrrat. Disa prej këtyre janë ëndrrat e narratorit, ndërsa tjerat të Ivan Nikolajevič- Bezdornit. Fenomenet jashtë shqisore i ndihmojnë shkrimtarit sidomos në lidhjen dhe gërshetimin e ngjarjeve fantastike siç është edhe romani *Mjeshtri e Margarita* i Bulgakovit. Nga biografia e tij e dimë se ai shpesh merrte morfina, madje disa herë i jepte edhe gruaja e parë e tij Tatjana Lapa. Në Rusinë e sotme vepra e sidomos filmi kritikohet nga klerikët e Kishës Ortodokse Ruse, për shkak të qëndrimit të autorit ndaj figurës së satanit. Ironia e tij ishte që t'i luftojë dhe fshikullojë veset e mbrapshta

njerëzore duke i dhënë rol pozitiv dhe human figurës së Wolandit përkundër njerëzve që kushtimisht duhet të jenë humanë dhe të virtutshëm.

Biseda e Mjeshtrit me Ivanin në spital na informon se ai mbi të gjitha e do njeriun, lirinë dhe jetën e dinjitetshme. Ai do t'i thotë Ivanit ndër të tjera: se ëndrra e tij ka qenë ta shëtite gjithë botën, nqs do të mundej por ai tani sheh vetëm një pjesë të parëndësishme të saj por jo edhe aq të keqe....Puritanizmi dhe morali i rrejshëm sjell deformime të atilla siç janë ndalimi dhe censurimi i besimit në Zot, dhe pikërisht ky fakt e detyron Bulgakovin ta përshkruajë figurën e Wolandit më njerëzore se njerëzit. Pengesa e Mjeshtrit nuk është revolta kundër vdekjes, por kundër padrejtësisë së jetës. Ai përjetësohet-vdes në një moshë relativisht të re, 38 vjeçare. Edhe pse Wolandi propozon rrugën e vetme të shpëtimit të tyre t'i bëjë ata të përjetshëm dhe kjo ishte rruga më e mirë ku ata do të ishin bashkë dhe të qetë në shtëpinë e tyre me kopshtin ku lulëzojnë lulet e qershisë ku ai do t'i shkruante veprat e tij i qetë në prani të dashurisë së tij të përjetshme Margaritës. Kjo formë e jetesës kjo ideologji e ka tjetërsuar njeriun dhe ai vepron kundër ligjeve të natyrës edhe kundër vetes. Baza shpirtërore e psikologjike e vuajeteve të narratorit është e plotësuar prej elementeve sociale dhe depërtimit të padrejtësive e dramave të jashtme në Unin e autorit-narrator tek i cili kur kombinohet imperativi i brendshëm me shtytjet e jashtme dhe kjo gjendje shpreh revoltën e narratorit ndaj këtyre dukurve ashtu siç i thotë Sartre-i në parimet e ekzistencializmit, kur dikush sëmuret, nuk flet, tërhiqet, mbyllet në vetevete për tu larguar nga tortura e tjerëve. Kjo gjendje e narratorit është njësi matëse e terrorit shtetëror, politik, ideologjik, e institucional ndaj intelektualëve të mirëfilltë. Kjo mungesë e lirisë e ka ndrydhur vullnetin e Mjeshtrit dhe ajo është kthyer në formë neuroze e pastaj psikoze. Atë e lirojnë nga burgu në një natë të acartë të Janarit, kthehet në shtëpi, por atë e kishte marrë Alojzie Mogariç. Duke e parë këtë situatë, Mjeshtrit i shuhen shpresat dhe vendos të endet rrugëve të Moskës pa e ditur se ku do të shkojë. Gjatë këtij dialogu ai i thotë Ivanit se nuk iu paraqit Margaritës pasi që nuk është mjeshtër i shkatërrimit, një letër e dërguar nga spitali psikiatrik do ta rrëronte atë. Para së gjithash pranoi të vuajë në vetmi se ta bëjë të vuajë të dashurën e tij.

Ivani nga rrëfimet e Mjeshtrit mbetet i mahnitur. Ai e quan nxënës Ivanin sepse shumë gjëra nuk i kishte të qarta, mbi të gjitha i kërkon falje dhe i thotë se nuk je mjaft i arsimuar ! Mos shkruaj sepse vargjet tua nuk vlejné për asgjë !

Hapësira Pilati lartë Jeshua poshtë, Latunski lartë në katin e tetë Mjeshtri në podrum ! ai është Promethe që shkon kundër rrymës së kohës, është hero tragjik, edhe Margarita gjithashtu, ajo e pranon vdekjen vetëm që të jetë bashkë me Mjeshttrin. Vepra është një ekuinoks (ndërrim stinësh) mes letërsisë moderne dhe asaj socrealiste. Tek kërcimet kohore nga Pontij Pilati, e deri tek Mjeshtri "është këputur zinxhiri i kohërave". Takimi me Margaritën e frymëzon si Melpomeni, i jep vullnet, dashuri dhe frymëzim për krijim, por anaforisht ajo do të jetë muza besnike që do shkojë drejt vdekjes me të, në botën e amshuar.

Autori është i helmuar nga realiteti i hidhur dhe si rrjedhojë ai e përpunon dhe sublimon atë, ndërton figura groteske në roman, duke i vënë ballë për ballë me djallin, këta figura të neveritura që askush prej tyre nuk mund tu vijë hakut përveç tij dhe me ironi e lufton të keqen. Autori si subjekt mishërohet me Mjeshttrin, jeton në të por ngrihet mbi të duke abstraguuar.

Determinizmi shoqëror: nuk i shihet fundi, e kaluara religjioze është e ngulfatur, e ardhmja është mbuluar nga një re e zezë, e dundur ku nuk shihet perspektivë, shkrija e emocionale me irracionalen japin groteskun. Elementet ekzistencialiste jeta në kufij të varfërisë ekonomike, varfëria, shpirtërore, liria e cunguar është më e keqe se privimi i lirisë. Shteti është i udhëhequr me ideale anemike dhe me efekte herostratiane.

Kronotopi ideologjik-politik, vepra luftë mes jetës e vdekjes dhe në fund Mjeshtri e Margarita zgjedhin vdekjen si shpëtim nga terrori, besojnë në transhendenten, përjetësinë, vazhdojnë të jetojnë në dimensionin e pestë, atë shpirtëror. Ashtu si harpa eoliane që tingëllon vetëm atëherë kur godet stuhia edhe Mjeshtri nuk mund të rrëfejë për Pilatin pa drithërima... e tërë vepra e Bulgakovit është një harpë eoliane që tingëllon fuqishëm nga goditja e madhe e uraganit.

Dëshprimi i Levi Matejit përbën sakrilegj. Edhe autorin-narrator dëshprimi e zhyt në depression dhe pesimizëm. Dhe po ky dëshprim Margaritën e shtyn drejt Wolandit për t'i kërkuar ndihmë. Viktima të determinizmit shoqëror dhe represionit politik: Mjeshtri, Margarita. Të hutur: Ivan Nikolajevič-Bezdomni. Djallëzor: Berlioz, Latunski, Lunaçarski, Arimani, Rimski, etj. Lakmitarë: masa popullit, pushtetarët.

Qeveria është më djallëzore se vetë djalli. Hapi i parë i represionit është lufta psikologjike, ata në fillim e luftojnë me anë të kritikave në gazeta. Mjeshtri kur i lexon ato në fillim qesh. Por valët e pandalshme të kritikave dhe sulmeve në shtyp bëjnë efektet e para, në fillim shqetësohet, pastaj fillon të frikësohet, bie në depression dhe më në fund e burgosin. Vështrimi i narratorit mbi njerëzit, sendet, objektet është diagonal dhe i thellë. Ai e kritikon masën e popullit e në veçanti byrokratët për adhurimin e liderit "gjysëmhyjnor", me ironi e tallje e mund padrjetësinë dhe absurdin e jetës. Edhe integrimi i personazheve transhendente është më pak befasues se absurdi i jetës politike e shoqërore të Moskës, vënia e Wolandit përballë moskovitëve është gjeturia më e përsosur e autorit.

Elementet biografike e bëjnë më të kuptueshëm qasjen ndaj vendeve mistike të tekstit. Vetë Bulgakovi kishte probleme ekzistenciale, banesore dhe probleme në jetën private. Ky element është mjaft interesant i cili është integruar në një formë të lartë artistike dhe estetike në roman. Mjeshtri përballet me gjysëmidiotë të cilët e pengojnë dhe hetojnë në çdo hap. Romani brenda romanit është një fakt se ai kishte të bënte me një kastë shoqërore në rënie morale e shpirtërore. Teatri Variete përfaqëson zbuluesin, vendi ku çirren maskat, i vendosur në një paralelizëm të kundërt me ballon e Wolandit ku Margarita ishte nikoqire. Edhe Bulgakov ka shkruar për strukturat e fshehta të qeverisjes, për demonizimin e qeverisjes. Duke i vënë ballë për ballë njerëzit dhe djallin, narratori na e bën të ditur se njerëzit dalin më djallëzorë se djalli, ndërrojnë rolet në mënyrë të pavetëdijshme, prandaj veprimi i djallit është si protestë dhe shprehje e revoltës për marrjen e kompetencave pa pranuar huamarrjen!

Ai e gjen dashurinë e vërtetë por ka pengesa. Trekëndëshi dashuror tashmë ka agjensë pengues. Motivet frojdiane dhe ëndrrat jungiane, arketipi, individual, kolektiv dhe familjar, janë shtypa pozitive dhe negative që e shtyjnë përpara subjektin e romanit. Margarita bën pakt me djallin, ajo pranon gjithçka, madje edhe zhvishet në natën e ballos së satanait, si dëshmi e dashurisë së fuqishme ndaj Mjeshtrit. Këta përshkrime aksiologjike janë karakteristikë funksionale e trajtimit të tipologjisë së personazheve, në procesin e ndërlikuar dhe sublim të krijimit. I gjithë helmi, vveri, dëshprimi dhe depresioni i autorit përpunohet dhe sublimohet, me ç'rast ai prodhon perllën artistike si rezultat i drithërimave shpirtërore nga goditjet e fatit. Ai shkrin të gjitha forcat mendore dhe emocionale, për t'i portretizuar personazhet me një vërtetësi dhe për t'i karakterizuar ata si nga tiparet e jashtme ashtu edhe brendashpirtërore.

Vendet: teatri, spitali, rruga Sadovaja, Patrijarshki ribnjaci (Pellgjet e Patriarkanës). Qytetet: Moskë. Rruga nderore si metaforë e arritjes në mbretërinë e dritës-Zotit. Takimi i Mjeshtrit dhe Margaritës është arketipor, i paracaktuar, imperativi i lirisë, që njeriu të jetojë si i tillë, etj. Romani përshkruan ngjarjet e Moskës nga e mërkura deri të shtunën. Aty narratori vazhdimisht ndërpret një ngjarje dhe vazhdon me tjetrën nga spitali psikiatrik ku bisedojnë Mjeshtri dhe Ivani, kalon tek skandali i teatrit Variete, ku djallëzitet e Fagotit çuan deri tek zhveshja e grave që i ndërruan rrobat e vjetra me të reja. Kjo hapi shumë punë për milicionerët dhe gjykatësit, ndërsa aktorët e këtij skeçi çuditërisht u zhdukën nga skena sa hap e mbyll sytë.

Autori ka ndërtuar me gjeturinë e tij të figurën e Berliozit dhe byrokratëve tjerë të shtëpisë së shkrimtarëve të Moskës të korruptua, mashtrues e manipulues. Demaskimin e tyre e bën Woland-i i cili është personazh që del jashtë kanonit biblik, ai nuk është djallëzor, por në këtë rast i drejtë, demaskues, dënues.

Temat që zënë hapësirën kryesore në roman, ajo e vdekjes, e natës, e dashurisë, destruksionit etj. Djegia e dorëshkrimit përbën një skenë më vete brenda romanit prej nga vjen edhe thënia e njohur "dorëshkrimet nuk digjen" Magjikja dhe grotesku zënë një vend të rëndësishëm. Roman i shkruar në vitet e tridhjeta që në kohën e realizmit socialist për të cilin vetë autori do të burgoset. Këto fakte biografike janë fije lidhëse mes Mjeshtrit dhe vetë autorit, në shumë segmente të romanit. Kronotopi i veprës mund të quhet ai transcendental dhe ngjarjet që e karakterizojnë atë. Margarita për Mjeshtrin është narrator i besueshëm ashtu siç është Wolandi për Margaritën dhe Mjeshtri për Bezdomnin (reliable narrator). Suspensi është prezent me dëmet dhe veprimet mbinatyrore që i bën satanai me shpurën e tij. Kjo është e evidente në teatrin e Moskës gjatë shfaqjes së magjisë së zezë nga Wolandi dhe pasojat tmerruese pas shfaqjes.

Lëvizjet e personazheve brenda kanoneve të skemës narrative ose asaj që historikisht është argumentuar janë të ndryshme. Disa nga personazhet e romanit duket të jenë realë të kohës kur jetoj autori, kritiku Lanuçarski, Lihaçevi etj, por personazhi i Jeshuas (Jezusit), del nga kanoni, si nga përgjigjet që i jep Pilatit, ashtu edhe nga qëndrimi ndaj gjyqimit të tij. Në fund nga goja e Levi Matej-it marrim vesh se Jeshua e dërgon atë si ndërmjetës tek Wolandi që ta shpëtojë Mjeshtrin dhe Margaritën nga mbretëria e errësirës, sepse ata nuk i përkasin asaj.

Autori e shpreh thelbin filozofik, përmes formës satirike të shkrimit. Rruga e dehumanizimit dhe degradimit me të cilën trajtohen njerëzit nga zyrtarët e institucioneve në Moskë. Pas natës dramatike kur Mjeshtri burgoset, ai e shkurton rrëfimin e tij me një fjali dhe menjëherë kalon tek kthimi i tij në shtëpi, në të cilën banonte një i huaj e ky ishte Alojzie Mogariç. I dëshpëruar largohet nga shtëpia një natë të acartë të janarit me një kapotë pa pulla, duke u endur në rrugët e Moskës siç thotë: "I ftohti dhe frika që ishin bërë përcjellësit e mi të përherëshëm, më shpunë deri në tërbim. Nuk kisha ku të shkoja dhe më mirë do të ishte të hidhesha nën tramvaj, në atë rrugë të lagjes sime. Nga larg e pashë dritën e një kutie të ngrirë dhe dëgjova kërcëllimën e urryer të saj në akull. Por fqinji im i dashur, e gjithë puna është se frika mbretëronte në çdo pjesë të trupit tim. Njëllon sikur qentë frikësohesha nga tramvajet."⁹⁶

E keqja asnjëherë nuk mund të zhduket, ajo mund vetëm të ripërpunohet dhe riformulohet, kur ajo shtypet jep efekt të kundërt. Njeriu është qenie e papërsosur, ai përsoset kur hyn në dialog me tjetrin dhe pranon mendimin ndryshe ose të kundërt. Por koha në të cilën jeton Mjeshtri ka një diktator dhe servilët e tij nuk e lejojnë një liri të këfillë.

⁹⁶ Mikhail Bulgakov, (2015), Mjeshtri dhe Margarita, Biblioteka Koha Ditore, Prishtinë, f. 156.

Tek Wolandi dhe gjykimet e tij narratori sheh cointidentia opositorum që d.t.th., që kërkojmë anën pozitive të tij ose në veprimet e tij, sipas Jungut. Portretizimi i kritikëve letrarë të cilët e kishin në dorë fatin e Mjeshtrit anon nga karikatura siç është pamja e Berliozit, derrat alias Nikolaj Ivanoviç që fluturon Natasha, etj. Në këto përshkrime më demonik se demoni del kritiku Berlioz, Arimani dhe Latunski (Lunaçarski). Wolandi i di të gjitha vuajtjet e Margaritës por ai e pyet atë se çfarë dëshiron të bëjë ai me armiqtë e tyre. Margarita nuk heq dorë nga hakmarrja kundër Latunskit dhe tjerëve. Bjelinski thoshte "Demoni mohon për të vërtetuar, shkatërron për të krijuar" i këtillë ishte edhe stili i të folurit të Wolandit edhe negacioni i fjalëve të tij, duke e përshkruan djallin si të këtillë Bulgakov e mëshiron për atë që është ai. Një kryeengjell që ka gabuar një herë nga lakmia dhe xhelozia për njeriun dhe Zotin, prandaj ka mbetur përjetësisht i mallkuar. Por më djallëzor se djalli ai i sheh moskovitët, sidomos ata që drejtojnë institucione dhe kanë në dorë fatin e intelektualëve të kalibrit të Bulgakovit, Jeseninit, Pasternjakut, Solzhenjicinit e shumë intelektualëve që u vranë ose u internuan në Ishullin e Gulagut.

Realiteti vdekjes i përshkruar në roman, është se Mjeshtri vdes në spital, ndërsa Margarita në të njëjtën kohë vdes nga probleme me stomakun në shtëpinë e vetë. Mënyra paralele e dy subjekteve të ndryshme dhe roleve që luajnë Mjeshtri dhe Margarita, tregon për ëndrrën e tij...Margarita është e pajisur me guxim në lojën për vdekje që luan, për ta shpëtuar dashurinë e saj dhe romanin e e Mjeshtrit. Ajo bën një gjest ndoshta jo edhe aq fisnik por të vendosur për Mjeshttrin, lakuriqësohet natën e ballos së djallit dhe pranon të gjitha kushtet.

*'Natyrish kur njerëzit janë të plaçkitur sikur ti dhe unë, kërkojnë shpëtim në forcat mbinatyrore! Pajtohem ta kërkojmë atje'*⁹⁷

Përfundimi: ironia tekstuale metanarrative që është refleksi i tekstit që kujdeset për veten, sipas Ekos. Wolandi është figment narrativ (fantastik, fabrikim, invencion). *Interes të veçantë për kritikun letrar ka fakti se elementet t një ëndrrë të dukshme kanë zëvendësuar elementet në mendimin-ëndërr, të fshehur nëpërmjet një zinxhiri asocimi, sepse aparatet figurative punojnë pikërisht nëpërmjet zinxhirëve të këtillë. Ekziston gjithashtu nocioni që ëndrra e dukshme ka një qendër të ndryshme nga mendimi-ëndërr, çka përputhet me synimin e kritikut letrar për të gjetur kuptimin e nënkuptuar, si ndryshim nga kuptimi i qartë* (Jefferson 213)⁹⁸

Te vepra Mjeshtri e Margarita vërehen elemente të filozofisë ekzistencialiste, në ato episode ku përsiatjet për jetën, vdekjen ankthin, frikën, e çojnë në pesimizëm Mjeshttrin. Kritikat e para në gazeta thotë mu dukën qesharake, por faza tjetër e kritikave filloi ta frikësojë dhe deprimojë, ai u bë apatik dhe çdo ditë priste kur do ta burgosnin. Në roman dominojnë elemente irracionale dhe idealizmi mistik, që siç duket e kanë përcjellë atë fund e krye. Shpesh kritika e thotë se Mjeshtri e Margarita përfaqëson një Bibël për Stalinin. I frymëzuar nga versetet biblike rreth dënimit të Joshuas, ai e dalton ngjarjen e vjetër duke i dhënë frymë të re dhe të përafërt me jetën e Mjeshtrit. Ky frymëzim është ndikuar nga jeta e Faustit dhe Margaritës së Goethe-s, por në këtë rast Bulgakov e ndërron rolin e Mjeshtrit, tani në miqësi me djallin është Margarita ajo që kërkon ndihmën e Wolandit e jo Mjeshtri, përderisa tek Fausti Margarita është një vajzë naive dhe viktimë e Mefistofelit dhe, gjithë këtë gjetje e përgatit Mefistoja që ti dhurojë rininë, pasionin dhe suksesin Faustit që në fund ta ketë nën përkujdesje shpirtin e tij! Analogjia tjetër është se në fund Fausti shpëton nga kthetrat e djallit dhe shpirtin e tij e marrin engjëjt, ashtu siç e paralajmëroi Zoti në fillim kur i dha leje që të shoqërohet me Faustin dhe ta provojë fatin e tij. Edhe Mjeshtri dhe Margarita me ndërmjetësimin e Joshuas shpëtojnë nga mbretëria e Wolandit sepse ata nuk e kishin merituar errësirën. Devijim nga kanoni biblik është fakti se Wolandi nuk është djallëzor por i drejtë, ai nuk zemërohet me Mjeshttrin e Margaritën sepse nuk i përkasin botës së tij në fund të fundit. Bulgakovi ia pa sherrin qëndrimin të tij mistik të trajtuar në roman, ndaj fenomeneve shoqërore dhe jetës së përditshme, imtësirave të saj në dukje të parëndësishme por plot domethënie në thelbin e tyre. Pasi tentoi ta botojë atë hasi në pengesa e më vonë edhe në kërcënime për romanin e papranueshëm, i cili ishte në kundërshtim me ideologjinë politike të kohës. Suksesi i Margaritës është një triumf i artit femëror, një epërsi e paprekshme me të cilin ajo shpëton dashurinë e saj.

Sipas Filip Selje, i cili i dallon mitet në disa veçanti thelbësore, shprehet kështu "miti etnoreligjioz është mit themelor anonim, kolektiv, i konsideruar si i vërtetë dhe i cili nëpërmjet analizës mundëson që të paraqiten kundërthënie të fuqishme strukturore, kur ai depërton në letërsi e respekton efektin simbolik dhe ndriçimin metafizik, megjithatë ai e humb shenjën e saktë dhe themelore të tij".⁹⁹

Përshtypja e komizmit lind nga kontrasti mes figurës aq të urryer të Llatunskit dhe goditjes që i bën Fagoti në Variete, me magji i fluturojnë dollarët nga xhepi. Këto elemente të goditura fantastike i japin estetikën e qenësishme si mënyrë e mirëfilltë krijuese e Bulgakovit. Kjo është edhe një mënyrë e mençur e thurjes, sepse autori me qeshje e

⁹⁷ Mikhail Bulgakov, (2015), Mjeshtri dhe Margarita, Biblioteka Koha Ditore, Prishtinë, f. 386.

⁹⁸ Jefferson, A. Robbey, D. (2004), Teoria Letrare Moderne, Albas, Tiranë-Tetovë, f. 213.

⁹⁹ Daniel-Henri Pageau, (1994), La littérature générale et comparée Arman Colin Edituer, Paris, f. 168.

lufton frikën, terrorin dhe shtypjen e qeverisë së kohës, ai çlirohet nga tradicionalizmi i mendimit, nga krijimi i censuruar, ky rebelim e bën Bulgakov-in të jetë jokonvencional, original dhe unik në artin e tij.

Ngjarjet e jashtme i sjellin stuhinë e fatalitetit, shoqëria, e vërteta historike, absurdi i një sistemi për të cilin kishin luftuar dhe tash një nga një i përpinte, u shpërlante trurin, i getoizonte dhe i detyronte shkrimtarët të shkruanin veprat e tyre sipas një skeme të ngushë ideologjike dhe nqs nuk bindeshin, pasonte dënimi, suspendimi, burgu dhe vdekja... Miti në letërsi zë një vend të rëndësishëm dhe luan rol enigmatik në ndërthurjen e një vepre apo, shpesh shërben edhe si mjegullnajë terminologjike e e saj dhe këto elemente nuk i mungojnë veprës së Bulgakov-it, ato janë invencion i domosdoshëm për ta mbrytur satirën politike të kohës së tij. Është një ndër veprat distopike më të arrira me përmasa universale.

LITERATURA

- [1] Bulgakov, M. (2015), Mjeshtri dhe Margarita, Biblioteka Koha Ditore, Prishtinë.
- [2] Jung, C. G. (2006), Psikologjia analitike, Fan Noli, Tiranë.
- [3] Fraj, N. (1990), Anatomia e kritikës, Rilindja, Prishtinë.
- [4] Тресидер, Цек, (2001), Речник на симболи, ТРИ, Скопје.
- [5] Sartre, J. P. (2011), Qenia dhe Hiçi I, Fan Noli, Tiranë.
- [6] Sartre, J. P. (2011), Qenia dhe Hiçi II, Fan Noli, Tiranë.
- [7] Carl Gustav Jung (2006), Kujtimet, ëndrrat, përsiatjet Fan Noli, Tiranë.
- [8] Jefferson, A. Robbey, D. (2004), Teoria Letrare Moderne, Albas, Tiranë-Tetovë.
- [9] Dado, F. (2003), Teoria e veprës letrare-Poetika, SHBLU, Tiranë.
- [10] Goethe, J. W. (1999), Fausti, ARGETA, Tiranë.
- [11] Adler, A. (2010), Të kuptosh natyrën e njeriut, Fan Noli, Tiranë.
- [12] Benda, J. (2014), The treson of the intellectuals, Transaction Publishers, New Brunswick (U.S.A.) and London (U.K.).
- [13] https://en.wikipedia.org/wiki/Thomas_Aquinas
- [14] https://en.wikipedia.org/wiki/The_Master_and_Margarita
- [15] <http://www.urbandictionary.com/define.php?term=Mephistopheles>